



Data: 07/11/2019

Ref.: 2276/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 76-të, të mbajtur më 25 dhe 26.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i Kolegji Iliria për periudhën tri vjeçare 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Juridik Civil, LLM 60 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik
- II. Nuk riakreditohet programi i Kolegji Iliria:
 - Juridik Penal, LLM 60 ECTS
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Iliria për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin Iliria më datë 28.06.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Johannes Falterbaum dhe znj. Delia Gologan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2019 dhe 26.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Iliria dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit Juridik Civil, LLM, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Sa i përket programit të studimit Juridik Penal LLM, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të Akreditimit, Kolegjit Iliria për këtë program të studimit plotëson 3 substancialisht, 3 pjesërisht dhe 1 nuk e plotëson, dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar mosdhënien e riakreditimit.

Ekipi i ekspertëve ndër të tjera ka konstatuar këto mangësi të cilat kanë qar në mosdhënien e akreditimit sipas kapitujve janë: 1. Misioni, objektivat dhe administrimi: mungesa e një misioni të kompozuar dhe kontradikta në definimin e misionit, mos adresimi i hulumtimit dhe nevojave të komunitetit brenda misionit. Ndonëse programi është hartuar duke marrë modele të Drejtës Private në Kosovë dhe të Drejtës Ndërkombëtare Evropiane, nuk është konsultuar fare askush rreth rezultateve të të nxënies (learning outcomes) të cilat studentët duhet ti fitojnë pas përfundimit të programit.

Në kapitullin e Stafit Akademik ekspertët numërojnë këto mangësi: Nuk ka një ndarje të qartë se cili staf akademik do të ligjëroj në programin i cili u vlerësua dhe krijohet përshtypja se i gjithë stafi do të involvohet në ligjërim. Gjatë vizitës, shumica nga stafi prezent nuk kishin ide se cilat lëndë do të ligjërohen nga ta.


Në kapitullin për Përmbajtjen e Procesit Mësimor ekspertët potencojnë nevojën për zhvendosje të lëndës së metodave të hulumtimit në semestrin e parë, në mënyrë që studentët të përgatiten mjaftueshëm në kohë me punimin e temës së diplomës së masterit. Institucioni nuk ka bërë një ndarje të qartë nga programi i nivelit bachelor, sidomos sa i përket stafit akademik. Syllabuset e programit duhet të kenë një vijë ndarëse më të qartë nga niveli bachelor sa i përket lëndëve të fushës penale.

Kapitulli për hulumtim nuk shfaq një plan me objektiva specifike, targete të matshme dhe resurse të parapara. Gjithashtu duhet të rritet përfshirja e studentëve në hulumtim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Iliria
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

